



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 02, Datë 22.01.2024

MBI

**“FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË
SHPËRNDARJES SË TË ARDHURAVE NGA KONGJESTIONI NDËRMJET
SHQIPËRISË DHE KOSOVËS”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; pikës 3.5 të Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 519, datë 13.07.2016 “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 3, pika 8 e “Rregullores së kërkesave dhe procedurave për përcaktimin e Operatorit të Emëruar të Energjisë Elektrike (NEMO) si dhe rolet e përgjegjësitë e NEMO dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë në tregun e bashkuar”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 40, datë 06.03.2020; neneve 15 dhe 19 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; si dhe “Marrëveshjes kornizë mbi bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës” të datës 21.10.2021, nënshkruar nga Enti Rregullator i Energjisë i Shqipërisë (ERE), Zyra e Rregullatorit për Energji e Kosovës (ZRRE), Operatori i Sistemit të Transmetimit të Shqipërisë (OST) sh.a. dhe Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Kosovës (KOSTT) sh.a.; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.01.2024, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 175 prot., datë 17.01.2024 të përgatitur nga Grupi i Punës “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e Metodologjisë së shpërndarjes së të ardhurave nga kongjestioni ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës dhe procedurave rezervë për bashkimin e tregut të energjisë elektrike të ditës në avancë Shqipëri - Kosovë”,

Konstatohet se:

- Në zbatim të nenit 6.4, nënparagrafit (h) të Marrëveshjes Kornizë, Rregullatorët do të miratojnë, ndër të tjera, metodologjinë e shpërndarjes së të ardhurave nga kongjestionet, të propozuar nga NEMO, OST dhe KOSTT.
- Shoqëria OST sh.a. me shkresën nr. 6250 prot., datë 06.12.2023, protokolluar me tonën me nr. 2070/1 prot., datë 07.12.2023, ka paraqitur në ERE “Propozimin për miratimin e Metodologjisë së shpërndarjes së të ardhurave nga kongjestioni ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës”.

- Kjo metodologji është hartuar në përputhje me ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, duke siguruar ndjekjen e procedurave transparente, jo diskriminuese, konkurruese, duke rritur integritimin e tregut vendas dhe sigurimin e furnizimit me energji elektrike.
- Kjo Metodologji ka për qëllim të rregullojë mënyrën e shpërndarjes së të ardhurave nga kongjestioni për (I) Zonat ofertuese të Shqipërisë dhe Kosovës dhe interkonektorët ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës ku mblidhen të ardhurat nga kongjestioni, (II) Të ardhurat nga kongjestioni që vijnë nga alokimi i kapaciteteve bazuar në qasjen e NTC së koordinuar dhe (III) Të ardhurat nga kongjestioni që vijnë nga alokimi i kapaciteteve ne harkun kohor të ditës në avancë.
- Metodologjia a shpërndarjes së të ardhurave nga kongjestioni ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës është miratuar ndërkohë nga Zyra e Rregullatorit për Energji e Republikës së Kosovës me vendimin e bordit të ZRRE V_1767 _2023, datë 21 shtator 2023.
- Akti i hartuar është strukturuar në dy pjesë, ku në pjesën e parë të metodologjisë përcaktohen qëllimi dhe objekti, baza ligjore mbi të cilën është hartuar kjo metodologji, përkufizimet dhe interpretimet si dhe procesi dhe llogaritja e të ardhurave nga kongjestioni. Në pjesën e dytë të metodologjisë përcaktohen parimet për ndarjen e të ardhurave nga kongjestioni, publikimi i të dhënave, zbatimi i metodologjisë dhe gjuha e përdorur në të.
- Metodologjia e Shpërndarjes së të Ardhurave nga Kongjestioni CID ka për qëllim të rregullojë mënyrën e shpërndarjes së të ardhurave nga kongjestioni për:
 - Zonat ofertuese të Shqipërisë dhe Kosovës dhe interkonektorët ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës ku mblidhen të ardhurat nga kongjestioni;
 - Të ardhurat nga kongjestioni që vijnë nga alokimi i kapaciteteve bazuar në qasjen e NTC së koordinuar;
 - Të ardhurat nga kongjestioni që vijnë nga alokimi i kapaciteteve ne harkun kohor të ditës në avancë.
- Në këtë metodologji përcaktohen parimet për ndarjen e të ardhurave nga kongjestioni, ku OST dhe KOSTT, do të marrin pjesën e tyre të të ardhurave neto kufitare bazuar në një koeficient të ndarjes 50% me 50%, duke i ngarkuar të publikojnë informacionin e kërkuar për transparencën e shpërndarjes së të ardhurave nga kongjestioni, për çdo fragment Njësi Kohore Tregu dhe së paku në baza mujore.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e “Metodologjisë së shpërndarjes së të ardhurave nga kongjestioni ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës”.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI